

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË



Nr. 267 Prot.



Rogozhinë më 10.08.2017.

Lënda: Dërgohet për shqyrtim dhe miratim ne Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit "Dokumenti i Planit të Përgjithshëm Vendor" i bashkisë Rogozhinë, për Aktin e Konformitetit.

Drejtuar: Znj. Adelina Greca

Drejtore e Përgjithëshme

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

E nderuar znj. Greca,

Bashkia Rogozhinë ka përfunduar dokumentin e hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit Administrativ, bazuar në Ligjin nr. 115/2014 datë 31.07.2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", si dhe në zbatimin e Ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në këtë proces, bashkia Rogozhinë, në mbështetje të Nenit 9, Ligji nr.107/2014 "Përgjegjësitet e Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit" neni 23, "Bashkërendim,këshillimi dhe shqyrtimi publik i dokumentave të planifikimit", si dhe në mbështetje të VKM nr. 671 datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", neni 59,gërmë "a" dhe "b", ju lutemi të shpreheni për Konformitetin e "Planit të Përgjithshëm Vendor" të bashkisë Rogozhinë.

Bashkangjitur kësak shkrese ju dërgojmë raportin mbi argumentimin e zonave industriale.

Kryetari

Beqir Nuredini





SEKRETARI
BASHKIA RROGOZHINË
Nr. 2767 Prot.

Rrogozhinë më 10.08.2017.

Argumentimi i Zonave Industriale

Bashkia e Rrogozhinës gjëzon një traditë të pasur në sektorin e industrisë, por sot ky sektor përfaqëson vetëm 11% të punësimit, të orientur drejt përpunimit bujqësor dhe blegtoral.

Industria përpunuase bujqësore dhe blegtore paraqet një potencial të lartë zhvillimi bazuar dhe në prodhueshmërisë e lartë bujqësore të zonës.

Bashkia e Rrogozhinës synon dhe një aktivizim të zejeve të traditës: përpunimi bujqësor e blegtoral si dhe oficina e fabrika të mirëmbajtjes së mjeteve bujësore apo dhe të lidhura me hekurudhën, për më tepër që tradita industriale e zonës (punëtorë të kualifikuar) lehtëson integrimin e aktiviteve industriale. Një nga faktorët që ndikon ndjeshëm në zhvillimin e sektorit industrial, përveç traditës së zonës, është dhe vendndodhja strategjike e bashkisë Rrogozhinë përgjatë Korridorit të VIII që siguron një ndërveprim të ngushtë ekonomik me rajonet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Lushnjë.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar e përfshin bashkinë Rrogozhinë në polin e rëndësishëm ekonomik Tiranë-Durrës duke orientuar këtë bashki drejt zhvillimit industrial dhe shërbimeve.

Aktualisht kjo bashki ka një sipërfaqe prej 40 ha të zonave industriale. Plani i Përgjithshëm Vendor rezervon rreth 164 ha tokë për aktivite industriale dhe ekonomike. Këto zona prodhimi e magazinimi duhet të respektojnë breza sigurie nga zonat e banimit, për këtë arsyе janë vendosuar në territor me akses të mirë dhe të distancuara nga vendbanimet. Përveç zonave të vogla tashmë me aktivitet ekonomik, janë 2 zona të mëdha kompakte të parashikuara në afërsi të autostradës: në Gosë (54 ha) si dhe pranë stacionit te ri hekurudhor në Rrogozhinë (110 ha). Sqarojmë që këto siperfaqe janë bruto, përfshijnë si rrjetet rrugore ashtu dhe brezat mbrojtës sipas detyrimeve përkatëse që do të përcaktohen në lejet mijdisore të aktiviteteve që do të vendosen në këto njësi.

Zona pranë stacionit hekurudhor kryen funksionet e një zone të lidhur me HUB-in kombëtar (Stacion Rrogozhinë), ndërsa zona në Gosë do sigurojë hapësira për industrinë dhe ekonominë lokale të Rrogozhinës, bazuar dhe në traditat industriale të këtij rajoni apo në kërkesa për zhvillime të fabrikave të vogla në shkallë lokale dhe rajonale.

Nëse zona në afërsi të qytetit të Rrogozhinës lidhet me zhvillimin e hekurudhës dhe me politika kombëtare, është territori në Gosë që siguron zonat e zhvillimit prioritar të ekonomisë në bashkinë Rrogozhinë. Ky territor do të krijojë në mundësi punësimi si për kategorinë e papunë sot ashtu dhe përiorientimin e tregut të punës.

Nisur nga faktet:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË



- popullsia e bashkisë Rrogozhinë do të jetë rreth 47,900 banorë në 2031
- zhvillimi teknologjik në sektorin e bujqësisë ka një ndikim negativ në punësim (ulje e nevojës për krahë pune),

është e nevojshme të zhvillojmë sektorin e industrisë dhe sektorin e shërbimeve për një përgjigje efikase të nevojave të tregut të punës. Nevojat për punësim në sektorin e industrisë dhe shërbimeve, për 2031 vlerësohen të jenë rreth 23,000 vende pune.

Duke marrë në konsideratë potencialin e zhvillimit të sektorit të industrisë dhe sektorit të shërbimeve, vlerësohet se do të nevojiten rreth 15,500 vende pune ne sektorin e industrisë dhe 7,500 vende pune në sektorin e shërbimeve. Në këtë kontekst zhvillimi i industrisë përbën një faktorët kryesorë në zhvillimin socio-ekonomik të Bashkisë Rrogozhinë.

KRYETARI
Beqir NUREDINI

